



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostignut Prijmljeno / Prihvaćeno Received / Dostignut		20.02.2023	3	viti god Year
Organ / Ujesta Organ / Jedinstvo Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHEK	1933/2023		115	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.58/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.58/2023 të datës 12.01.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Dragashit, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.02.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 58/2023 e datës 12.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.02.111/01-1823/22 i datës 21.12.2022 i Komisionit Disiplinor në Komunës së Dragashit.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Komunën e Dragashit, me datë 12.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 215/2023 e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.58/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02.111/01-1823/22 të datës 21.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Dragashit, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor nuk e ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr. 871/2022 sipas vërejtjeve të dhëna

dhe nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të saj, por ka mbetur pranë vendimit të parë në të cilën ka lënë në fuqi vendimin Nr. 02.111/15-12490/22 duke bërë shkelje të dispozitave të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 19.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit të Komuna e Dragashit, ndërsa me datën 30.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 5938/2022 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; Vendimi për largimin nga shërbimi civil i lëshuar nga Komisioni Disiplinor për Shërbyesit Civil me numër 02.111/15-12490/22 e datës 05.09.2022; Kërkesa për pushim vjetor 2022 për periudhën kohore 27.06.2022 deri 27.07.2022; Kërkesa për pushimin vjetor 2021 për periudhën kohore 07.06.2022 deri 24.06.2022; Përgjigje në kërkesë me numër të referencës 13/520 e datës 26.07.2022; Kërkesë për pushim pa pagesë e datës 15.07.2022; Kërkesë për pushim mjekësor për periudhën kohore 10.05.2022 deri 06.06.2022; Pliko e bardhë e datës 03.10.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.10.2022; Përgjigja në ankesë e dërguar përmes E-mailit me numër të protokollit 6299/2022 e datës 19.10.2022; Akt emërimi për ankuesin i datës 05.01.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Raport Mjekësor për ankuesin; E-mail i dërguar nga Y.E drejtuar B.Xh dhe S.K e datës 21.07.2022; E-mail i dërguar nga S.K drejtuar Y.E e datës 27.07.2022; Kërkesa e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Dragashit për formimin e Komisionit Disiplinor ndaj Ymer Ejupi me numër 131548 e datës 10.08.2022; E-mail i dërguar nga M.E drejtuar Y.E e datës 02.09.2022; Njoftimi për mbajtjen e seancës së parë të Komisionit Disiplinor i datës 25.08.2022; Vendim për caktimin e Komisionit Disiplinor për Shërbyesit Civil në Institucionet e Komunës së Dragashit me numër 112/12-22635/12 i datës 18.08.2022, Autorizimin e datës 05.10.2022; Vendimi Vk.nr.159/2022 për shtyrjen e afatit i datës 21.11.2022; Vendimi A.nr. 871/2022 i Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës i datës 05.12.2022; Procesverbali i Kolegjit për ankesa i datës 05.12.2022; Ankesa me numër të protokollit 215/2023 e datës 12.01.2023; Çertifikatën e lëshuar nga Koltusminister Konferenz e datës 26.04.2021 (në gjuhën gjermane dhe e përkthyer në gjuhën shqipe); Vërtetim i detyrimit për të marrë pjesë në kursin e integritimit i lëshuar nga Zyra e Emigracionit LRA Pfaffenhofen e datës 22.08.2022 (në gjuhën gjermane dhe e përkthyer në gjuhën shqipe); Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 19.01.2023; Plotësim ankese e datës 30.01.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.01.2023; Vendimi i Komisionit Disiplinor Nr.02.111/01-1823/22 i datës 21.12.2022; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Fatmir Berisha" - Prizren me nr.prot.285/22 e datës 19.12.2022; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Fatmir Berisha" - Prizren me nr.prot.286/22 e datës 19.12.2022; Shkresë- Postim në Facebook e datës 14.11.2022; Shkresë- Postim në Facebook e datës 01.12.2022; E-mail i dërguar nga M.E drejtuar KPMSHCK i datës 30.01.2023; Ftesë për ankuesin e lëshuar nga Drejtorati për Administratë të Përgjithshme me 03.Nr.111/01-1823/22 i datës 14.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 05.01.2015 është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Buxhet dhe Financa -2* pranë Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Dragashit, ndërsa Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 10.08.2022 kishte iniciuar procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mungesës në punë, kurse Komisioni Disiplinor i Komunës së Dragashit përmes Vendimit me numër 02.111/15-12490/22 të datës 05.09.2022 kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për shkak të mungesës në punë, dhe si rrjedhojë të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"*.

Ankuesi ka parashtruar ankesë të regjistruar me numër A.nr.871/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 06.10.2022, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor për largim nga shërbimi civil. Nga shqyrtimi i ankesës së datës 06.10.2022 Kolegji i Këshillit pas administrimi të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi kishte parashtruar kërkesë në Komunën e Dragashit për aprovimin e pushimit pa pagesë për periudhën kohore nga data 15.07.2022 deri me datë 30.06.2023 me arsyetimin se, citoj: *"kërkesën e arsyetoj ngase gjendem jashtë shtetit për rregullim e dokumentacionit familjar dhe vizitë shëndetësore"*, mirëpo kjo e fundit me datë 26.07.2022 i kishte kthyer përgjigjen me numër referenece:13/520 duke lënë të kuptohet se kërkesa për pushim pa pagesë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ngase e njëjta kërkesë nuk është mbuluar me dokumentacionin përkatës, si rrjedhojë për shkak të mungesës në punë pa arsye Komisioni Disiplinor të njëjtit i kishte shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka nxjerrë Vendimin A.nr.871/2022 të datës 05.12.2022 përmes të cilës ka shfuqizuar Vendimin me numër: 02.111/15-12490/22 të datës 05.09.2022 të Komisionit Disiplinor dhe çështjen e ka kthyer në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* të organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Komunës së Dragashit me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike. Tutje, Komisioni Disiplinor në Komunën e Dragashit pas rishqyrtimit të lëndës dhe provave materiale, përmes Vendimit Nr.02.111/01-1823/22 të datës 21.12.2022 ka lënë në fuqi masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"*.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor Nr.02.111/01-1823/22 të datës 21.12.2022, me datë 12.01.2023 ka parashtruar ankesën A.nr.58/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor duke mbetur pranë vendimit të parë për ndërprerje të marrëdhënies se punës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa përmes plotësimit të ankesës, përfaqësuesi i ankuesit me datën 30.01.2023 ka shtuar se Komuna pavarësisht se kanë qenë të njoftuar se e përfaqëson ankuesin nuk e kanë ftuar në seancën e cila do të mbahej në Komunën e Dragashit, po ashtu ka bashkangjitur certifikatën e vlerësimit për kualifikimin universitar të lëshuar me datë 26.04.2021 nga KMK-Konferenca e Ministrave të Kulturës-Zyra Qendrore për të huaj mbi pranimin nga shteti gjerman të Diplomës Master të ankuesit të cilin ka fituar në Universitetin Ukshin Hoti në Prizren, si dhe Vërtetimi e datës 22.08.2022 lidhur me detyrimin e ankuesit për të marrë

pjesë në kursin e integritit (për shkak të aftësive gjuhësore) me pretendimin se ankuesi ka kërkuar pushimin pa pagesë me qëllim të vazhdimit të studimeve Master jashtë vendit.

Mirëpo, Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Dragashit, përmes përgjigjes në ankesë të datës 30.01.2023 ka deklaruar se ankuesi ka shkuar në Gjermani së bashku me familjen për të punuar e jo për të studiuar apo për shërim, dhe po ashtu ka bashkangjitur edhe dëshmitë mbështetëse për këtë pretendim, gjegjësisht Vërtetimin me Nr.Prot:285/2022 të datës 19.12.2022 dhe Vërtetimin tjetër me Nr.Prot:286/2022 të datës 19.12.2022 të lëshuar nga SHFMU "Fatmir Berisha" në Komunën e Prizrenit përmes të cilëve dëshmohet fakti se të dy (2) vajzat e tij nxënëse të kësaj shkolle e kanë ndërprere shkollim me qëllim të bashkimit familjar me prindin i cili ka migruar në Gjermani.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ankimore analizoi dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 18 paragrafi 4 dhe 5 ku përcaktohet se: 4. *Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës.* 5. *Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë*", po ashtu ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, neni 14 paragrafi 2 dhe 3, nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 ku përcaktohet se: "*Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional; 2.2. shëndetit të tij/saj, apo pjesëtarëve të familjes së ngushtë; 2.3. për transferim të përkohshëm në detyra të tjera brenda apo jashtë vendit; 2.4. për kandidim në zgjedhjet komunale apo qendrore.* 3. *Për realizimin e te drejtës për pushim pa pagës sipas paragrafit 1 te këtij neni zyrtari publik duhet te paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. Kërkesa duhet te dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Vendimi i dorëzohet pa vonesë Zyrtarit dhe Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore*" si dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se: "*1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuari të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit*" dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstatoi se zyrtarëve publikë, në rastin konkretë nëpunësve civil u takon e drejta në pushim pa pagesë, mirëpo vetëm nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas nenit 14 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, andaj pas administrimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankuesi nuk i ka plotësuar këto kritere ashtu që sipas dëshmisë së bashkangjitur për pranimin e Diplomës nga Shteti Gjerman dhe Vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Emigracionit LRA Plaffenhofen për detyrimin për të marrë pjesë në kursin e integritit, vërtetohet fakti se nuk kemi të bëjmë me *ngritje apo arsimimi më të lartë profesional* të paraparë edhe me neni 14 paragrafi 2 dhe 3, nën paragrafët 2.1 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, por me pjesëmarrje në kursin e integritit i cili është obligativ për të huajt të cilët kanë marrë leje qëndrim në shtetin përkatës, e që kanë nevojë për integrim ose marrin pagesën e papunësisë në Shtetin Gjerman dhe e njëjta dëshmi nuk paraqet fakt relevant se ankuesi është regjistruar në ndonjë institucion arsimor me qëllim të arsimimit të lartët apo ngritjes profesionale arsimore dhe mbi këtë

bazë nuk është plotësuar kriteri i lartcekur, respektivisht pretendimi ankimor i ankuesi është i pabazuar ligjërisht.

Andaj, pas administrimit të provave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara, ndërsa Vendimi i Komisionit Disiplinorë është i bazuar në ligj siç përcaktohet edhe me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Shkelje të rënda konsiderohen: 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë”* ngase ankuesi për shkak të mungesës në punë për më shumë se pesë (5) ditë pa ndonjë arsye bindëse apo të lejuar sipas dispozitave të ligjit material ka kryer shkelje të rënda disiplinore, dhe në rrethanat e rastit konkret shqiptimi i masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor është bërë në pajtueshmëri me kompetencën që ia ka njohur Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët Publik në nenin 48 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”* ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjti ligj: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”*.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.58/2023

Flakron GASHI



Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të palës ankuese,
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.